

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Nëntor 2022


Tiranë, më 22 Dhjetor 2022: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Nëntor 2022, janë 808.813. Ky tregues rezulton me një rritje 47,4 %, krahasuar me Nëntor 2021. Në Nëntor 2022, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 358.350. Ky numër është rritur me 46,8 %, krahasuar me Nëntor 2021 (tab.1).

Hyrjet e shtetasve

Në Nëntor 2022, nga vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Spanja ka pasur rritjen më të madhe me 2,4 herë dhe Italia me 62,9 %, krahasuar me Nëntor 2021.

Gjatë njëmbëdhjetëmujorit 2022, nga vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Spanja ka pasur rritjen më të madhe me 3,7 herë dhe Anglia me 93,8 %, ndërsa Zvicra ka pasur rritjen më të ulët me 13,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 22/12/2022

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Nëntor 2022, janë 838.056, duke shënuar një rritje me 41,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Nëntor 2022 janë 463.097. Krahasuar me Nëntor 2021, ky numër është rritur me 47,9 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Nëntor 2022, janë 374.959. Krahasuar me Nëntor 2021, ky numër është rritur me 33,9 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë njëmbëdhjetëmujorit 2022, është 5.247.008, duke u rritur 36,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

| Periudha | Nëntor 2021 | Nëntor 2022 | Ndryshimi vjetor (%) | Janar-Nëntor 2021 | Janar-Nëntor 2022 | Ndryshimi vjetor (%) |
|-----------------------|----------------|----------------|----------------------|-------------------|-------------------|----------------------|
| Hyrje gjithsej | 548.819 | 808.813 | 47,4 | 8.949.247 | 12.044.120 | 34,6 |
| Shqiptarë | 304.758 | 450.463 | 47,8 | 3.528.007 | 4.891.878 | 38,7 |
| Të Huaj | 244.061 | 358.350 | 46,8 | 5.421.240 | 7.152.242 | 31,9 |
| Dalje gjithsej | 593.000 | 838.056 | 41,3 | 8.999.930 | 12.336.431 | 37,1 |
| Shqiptarë | 313.058 | 463.097 | 47,9 | 3.847.877 | 5.247.008 | 36,4 |
| Të Huaj | 279.942 | 374.959 | 33,9 | 5.152.053 | 7.089.423 | 37,6 |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Nëntor 2022, numri i shtetasve të huaj të hyrë në territorin e Shqipërisë për qëllime “Personale” është 352.344, duke u rritur me 49,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

| Periudha | Nëntor 2021 | Nëntor 2022 | Ndryshimi vjetor (%) | Janar - Nëntor 2021 | Janar - Nëntor 2022 | Ndryshimi vjetor (%) |
|---------------------------------------|----------------|----------------|----------------------|---------------------|---------------------|----------------------|
| Hyrje Shtetas të Huaj | 244.061 | 358.350 | 46,8 | 5.421.240 | 7.152.242 | 31,9 |
| I. Personale | 235.380 | 352.344 | 49,7 | 5.329.977 | 7.054.331 | 32,4 |
| 1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj. | 224.678 | 337.484 | 50,2 | 5.167.612 | 6.716.069 | 30,0 |
| 2. Trajtime shëndetësorë | 143 | 101 | -29,4 | 1.408 | 2.367 | 68,1 |
| 3. Qëllime fetare | 46 | 27 | -41,3 | 467 | 462 | -1,1 |
| 4. Udhëtarë transit | 10.513 | 14.732 | 40,1 | 160.490 | 335.433 | 109,0 |
| II. Biznes dhe profesionale | 8.681 | 6.006 | -30,8 | 91.263 | 97.911 | 7,3 |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2022, hyrjet dhe daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit paraqiten:

Numri i shtetasve që kanë hyrë:

- Nga pikat ajrore është rritur me 74,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Nga pikat detare është rritur me 45,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Nga pikat kufitare tokësore është rritur me 26,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i shtetasve që kanë dalë:

- Nga pikat ajrore është rritur me 76,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Nga pikat detare është rritur me 55,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Nga pikat kufitare tokësore është rritur me 28,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, (tab3).

Tab. 3 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

| Periudha | Hyrje gjithsej | | | Dalje gjithsej | | |
|-----------------------------|----------------|-------------|-------------|----------------|-------------|-------------|
| | Ajër | Det | Tokë | Ajër | Det | Tokë |
| Nëntor 2021 | 109.150 | 20.797 | 418.872 | 119.837 | 17.308 | 455.855 |
| Nëntor 2022 | 185.639 | 20.332 | 602.842 | 203.286 | 19.319 | 615.451 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 70,1 | -2,2 | 43,9 | 69,6 | 11,6 | 35,0 |
| Janar- Nëntor 2021 | 1.306.377 | 447.394 | 7.195.476 | 1.328.553 | 429.054 | 7.242.323 |
| Janar- Nëntor 2022 | 2.283.246 | 649.477 | 9.111.397 | 2.343.226 | 667.893 | 9.325.312 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 74,8 | 45,2 | 26,6 | 76,4 | 55,7 | 28,8 |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi "vizitor" nënkupton "një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse".

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.;
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.